

**Rezoluta nr. 103
e AKSIONARIT TE VETEM
të
Bankës Amerikane të Investimeve SHA**

Në Tiranë, sot, më 6 Shtator 2019, në selinë e Bankës Amerikane të Investimeve SHA, Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Njësia Bashkiake nr. 10, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, u mbledh aksionari i vetëm i Bankës Amerikane të Investimeve SHA (referuar si "**Banka**"),

Tranzit SHPK, me seli në Rruga e Kavajës, Ndërtesa 59, Kati 3, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, me NUIS K91624020M, perfaqësuar nga Vilsa Lika, ne baze te autorizimit te dhene me ane te Vendimit te ortakeve te Tranzit date 18 Korrik 2019.

Duke patur parasysh se:

- I. Tranzit eshte Aksionari i vetem i Banka Amerikane e Investimeve SHA;
- II. Banka Amerikane e Investimeve SHA ka marre miratimin paraprak te Bankes e Shqiperise per Transferimin e pjeses se mbetur te Borxhit te Varur ne kapital te paguar te Bankes dhe rritje te kapitali aksioner.

VENDIM:

1. Transferimi i pjesës së mbetur të Borxhit Varur në vlerën Euro 3,000,869.67 (tre milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë e gjashtëdhjetë e shtatë cent) në kapital të paguar të bankës;
2. Kontrata aktuale e Borxhit të Varur do të perfundojë. Pjesa e mbetur prej EUR 30.57 (tridhjetë e pesëdhjetë e shtatë cent) do t'i paguhet Tranzit shpk,
3. Kapitali i Bankës do të rritet përkatësisht me këtë transferim. Rritja e kapitalit realizohet nëpërmjet rritjes së numrit të aksioneve, duke emetuar 10,152 (dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) aksione të reja, me vlerë nominale për aksion prej 295.59 Euro (dyqind e nëntëdhjetë e pesë e pesëdhjetë e nëntë cent) që i korrespondon vlerës në lekë prej 36,000.65 (tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e pesë cent).
4. Kapitali i paguar i Bankës do të arrijë në vlerën 25,057,179.31 Euro (njëzet e pesë milionë e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë e tridhjetë e një cent) që i korrespondon vlerës në lekë prej 3,450,934,674.69 (tre miliardë e katërqind e pesëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër e gjashtëdhjetë e nëntë cent) i përbërë nga 84,769 aksione me vlerë nominale EUR 295.59 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë e pesëdhjetë e nëntë cent) që i korrespondon vlerës në lekë prej 40,709.86 (dyzetmijë e shtatëqind e nëntë e tetëdhjetë e gjashtë cent).

Aksioneri i Vetem i Bankes

Tranzit SHPK
Perfaqësuar nga
Vilsa Lika